



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 236, Datë 20.12.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KODIT TË RJETIT TË TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR” NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 16 dhe 44 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, mbasi shqyrtoi relacionin nr 119/5 prot, datë 18.12.2019, e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror”.

Konstatoi se:

- Në mbështetje të nenit 44 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, ERE miraton Kodin e Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror.
- Kodi i Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/459 e datës 16 mars 2017 për krijimin e një kodi të rrjetit mbi kapacitetin shpërndarës të sistemeve të transmetimit të gazit, Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 312/2014 të datës 26 Mars 2014 për krijimin e një Kodi të Rrjetit për Balancimin e Gazit në Rrjetet e Transmetimit /ENTSO-G CAM NC Modeli i Termave dhe Kushteve kryesore /Rregulloren (BE) Nr. 703/2015 e datës 30 Prill 2015. Krijimi i një kodi të rrjetit mbi rregullat e ndërveprimit dhe shkëmbimit të të dhënave /Kodin e Rrjetit TAP /Marrëveshjen e Transportit të Gazit TAP /Kodin e Transmetimit të Gazit i Irlandës Veriore dhe një numër dokumentash shoqërues /Kodin e Rrjetit i Sistemit Grek të Transmetimit të Gazit /Kodin e Rrjetit të Gazit SNAM Rete /Dokumenta të tjera rregullatore përkatëse.
- Në funksion sa më sipër, ky dokument synon të kontribuojë në krijimin e Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror në Shqipëri mbi baza jo-diskriminuese për të gjitha palët me qëllim arritjen e objektivave Strategjike në këtë Sektor. Gjithashtu synohet që të arrihet një planifikim dhe operim koherent dhe i koordinuar ndërmjet Operatorit të Kombinuar të

Gazit Natyror “ALBGAZ” sh.a. dhe gjithë përdoruesve të rrjetit të Gazit aktual ose që do të krijohen në të ardhmen, me qëllim vendosjen e kushteve më të mira të mundshme për zhvillimin dhe funksionimin e një tregu të integruar dhe efektiv të Gazit Natyror.

- Kodi i Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror trajton çështjet që lidhen me planifikimin dhe operimin e sistemit të gazit në tërësi dhe aksesin e aktorëve të tregut në rrjetin e transmetimit të Gazit Natyror në Shqipëri.
- Kodi i Rrjetit të Transmetimit parashtron normat, rregullat, procedurat dhe kërkesat e përgjithshme dhe themelore që drejtojnë operimin dhe zhvillimin e sistemit të Gazit Natyror në vendin tonë.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror” në Shqipëri.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI